



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

*Kancelari*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shkodër me \_\_\_/\_\_\_ 2017

**Lënda: Dërgohet raporti vjetor i monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2016**

**Drejtuar: Ministria e Arsimit dhe Sportit**

**Drejtoria e Financës**

**Tirane**

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, u hartua raporti vjetor për vitin 2016.

Detajimi i buxhetit për vitin 2016 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë. Detajimi është realizuar duke mbajtur parasysh objektivat, qëllimin e synuar, përfituesit.

Hartimi i materialit të realizimit të buxhetit për vitin 2016 u bë në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.9936 Dt.26.06.2008 „Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, ligjit nr.147/2015, dt. 17.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, dt. 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit“, udhëzimi nr.34, dt.28.12.2015 “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2016“, ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar); të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 „Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“.

Granti i pakushtezuar i akorduar nga Ministria e financave për Universitetin e Shkodrës ka ardhur me shkresën nr.17761/94, dt.07.01.2016. Ky grant është detajuar për të mbuluar shpenzimet korente.

Miratimi i buxhetit për vitin financiar 2016 është bërë me vendimet e organeve kolegjiale të USH-së, perkatesisht vendimin e senatit akademik nr.15, dt.14.01.2016 „Per miratimin e buxhetit te Universitetit per vitin 2016“, dhe vendimin e keshillit te administrimit te Ush-se nr.19, dt.15.01.2016. Gjate vitit 2016 jane bere shume pak ndryshime ne planin e investimeve, në regjistrin e parashikimit te prokurimeve publike, ne planin e te ardhurave.

Një analizë më e detajuar për fondet e miratuara për Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi për vitin 2016, së bashku me të ardhurat dytësore të realizuara për periudhën 12 mujore 2016, sipas grup artikujve janë sa vijon:

Tab.1 Buxheti 2016

Emri i programit	Buxheti i miratuar 2016	Buxheti i rishikuar 2016	Realizimi i 12 mujorit 2016	
	ne milion leke	ne milion leke	ne milion leke	ne % ndaj planit
Arsimi i larte	594.924.104	591.783.184	497.954.076	84,14%
Universiteti i Shkodres				

Tab.2 Realizimi i buxhetit si nga granti ashtu edhe nga te ardhurat dytesore ne total sipas artikujve te shpenzimit:

art/kodi	Emri	PBA plan 2016	Buxheti i miratuar 2016	Buxheti i rishikuar 2016	Fakti 12 mujori 2016	Diferenca	Realizimi ne % ndaj planit
600	Paga	424.344.000	361.637.000	361.380.900	324.404.525	36.976.375	89,77%
601	Sigurime Shoqërore	60.890.000	49.830.000	49.830.000	49.104.264	725.736	98,54%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	88.422.000	76.898.953	77.005.931	55.527.509	21.478.422	72,11%
605	Transferta Korente të Huaja	350.000	0	0	0	0	0,00%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	62.984.000	48.812.000	44.068.100	33.785.500	10.282.600	76,67%
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	920.000	920.000	0	920.000	0,00%
231	Kapitale të trupëzuara	239.754.000	56.826.151	58.578.253	35.132.278	23.445.975	59,97%
	<b>Totali</b>	<b>876.744.000</b>	<b>594.924.104</b>	<b>591.783.184</b>	<b>497.954.076</b>	<b>93.829.108</b>	<b>84,14%</b>

**Buxheti i miratuar për vitin 2016 ka synuar të realizojë objektivat e parashikuara.**

*Fondet për shpenzimet korente, ku përfshihen fondet për shpenzime personeli si dhe fondet për shpenzime për blerje materiale dhe shërbime arrijnë në masën 488.216.831 leke ose 82.5% e tërësisë së fondeve të miratuara për vitin 2016, ndërsa realizimi i shpenzimeve korente për vitin 2016 është në masën 87,88%.*

*Fonde për shpenzime kapitale janë 59.498.253 lekë ose 10.05% e tërësisë së fondeve të miratuara për vitin 2016.*

*Realizimi i shpenzimeve kapitale per 12- mujorin 2016 është në masën 59.97%.*

a) **Fondet e shpenzimeve për personelin për vitin 2016;** janë planifikuar në shumën 411.210.900 lekë, fond i cili garantoj mbulimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore të numrin aktual të punonjësve (definitiv dhe me kontrate të perkohshme pune). Shpenzimet e personelit të miratuar për vitin 2016 zënë rreth **69.5 %** e buxhetit të vitit 2016, ndërsa ndaj shpenzimeve korentë janë në masën 84.2 %.

Struktura e Universitetit të Shkodrës Luigj Gurakuqi është miratuar nga organet kolegjiale: Senati Akademik dhe Keshilli i Administrimit. Struktura organizative dhe organika analitike për vitin 2016 për punonjës të brendshëm ishte 344 punonjës, e realizuar në masën 83.4%. Ndërsa për punonjës të jashtëm dhe me kontrate 404 punonjës.

b) **Fondet për shpenzime korentë/operative për blerje mallra dhe shërbime;** Fondet e miratuara për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbime nga të tretë për vitin 2016 janë 77.005.931 lekë ose 13.01% e buxhetit. Zërat kryesorë në këtë grupartikull të shpenzimeve të tjera korrente janë: shpenzime për mbulimin e kontratave publike si energji, ujë, shërbim telefonie fikse, internet, ekspedita studentesh, blerje kancelari, materiale pastrimi, shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike, blerje karburant për ngrohje, honorare senati, taksa e tarifa, shpenzime të tjera operative etj.

Jane realizuar 6 procedura prokurimi nën zerin shpenzime korentë/operative për blerje mallra dhe shërbime me procedura prokurimi si: procedura e hapur, kerkese për propozim, negociim pa shpallje, në përputhje me miratimin e regjistrimit të parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2016. Blerjet e vogla nuk janë të përfshira në tabele.

Tab3

<b>Objekti i prokurimit</b>	<b>Fondi limit me tvsh</b>	<b>Vlera fituese me tvsh</b>	<b>Lloji i procedurës</b>
Kancelari	1,500,000	1,163,480.52	kërkesë për propozim
Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	1,500,000	1,332,948	kërkesë për propozim
Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjishme si llampa, priza, celesa, etj	1,500,000	876,000	kërkesë për propozim
Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	21,900,000	21,630,479	procedurë e hapur
Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes 20% për 2016	3,410,554	3.410.553;6	negociim pa shpallje
Gazoil, Karburant dhe vaj	5,000,000	5.000.000	kërkesë për propozim
Udhëtim i brendshëm ekspedita	6,500,000	6,439,375	kërkesë për propozim

b) *Fonde për shpenzime kapitale janë 59.498.253 lekë ose 10.05% e tërësisë së fondeve të miratuara për vitin 2016. Realizimi i shpenzimeve kapitale per 12- mujorin 2016 është në masën 59.97%.*

*Eshte realizuar 1 procedure prokurimi nen zerin shpenzime kapitale me procedure prokurimi te hapur ne perputhje me miratimin e regjistrit te parashikimit te prokurimeve publike per vitin 2016.. Blerjet e vogla nuk jane te perfshira ne tebele.*


Tab.4

Objekti i prokurimit	Fondi limit me tvsh	Vlera fituese me tvsh	Lloji i procedures
Paisje kompjuteri	4,000,000	3,087,732	kërkesë për propozim

Tab.5

Struktura e fondeve te planifikuara ne buxhetin 2016


Struktura e fondeve te realizuara ne buxhetin 2016




Tab.6

Struktura e fondeve te planifikuara ne buxhetin 2015


Struktura e fondeve te realizuara ne buxhetin 2015



Tab.7



Tab.8



**Bursat e studenteve**

Sa i takon dhenies se bursave te studenteve per vitin akademik qe mbaroi 2015-2016, eshte respektuar legjislacioni ne fuqi sipas vkm-se nr.911, dt. 11.11.2015 “Per percaktimin e kriterëve per perfitimin e bursave dhe pagesave te tarifave te ushqimit ne mensa e konvikte per nxenesit e studentet ne institucionet arsimore publike, per vitin akademik 2015-2016”.

*Nga vitet e para kane perfituar burse 334 studente, ndersa vitet e dyta e te treta 338 studente. Nga kategorite e vecanta kane eprfituar 19 studente. Ne total numri i perfituesve per vitin akademik 2015-2016 ka qene 691 studente. Fondet e perdorura per bursat jane levruar nga MAS ne formen e grantit te kushtezuar dhe jane shpenzuar ne masen 76.67%.*

### ***Te ardhurat dytesore***

*Nje burim financimi shume i rendesishem per IAL-te jane te ardhurat dytesore.*

*Tarifat e shkollimit per vitin akademik 2015-2016 jane arketuar ne mbeshtetje te :*

- VKM nr. 638, datë 22.08.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016”, i ndryshuar;*
- 2) VKM nr. 808, datë 3.10.2015 “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015-2016”;*
- 3) Udhëzimi Nr. 24, datë 31.07.2015 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016”, ndryshuar;*
- 4) Udhëzimi Nr. 26, datë 18.08.2015 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimin për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016”, i ndryshuar;*
- 5) Udhëzimi Nr. 29, datë 21.08.2015 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbërit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë”;*

*Viti financiar 2016 ka filluar me shumen prej 99.698.301 leke (te ardhura te trasheguara nga viti 2015).*

*Gjate vitit 2016 jane realizuar te ardhura ne masen 142.206.940 leke. Theksojme se zerin me te madh perbejne arketimet nga tarifat e shkollimit. Ne total per vitin 2016, te ardhurat e realizuara kane qene ne masen 241.905.241 leke duke perfshire edhe te ardhurat e trasheguara nga viti 2015.*

Tab.9 Realizimi i te ardhurave per vitin 2016

Artikulli	Lloji I te ardhurave	Shuma
7109600	Qera	140,000
7110103	Tarifa regjistrimi	4,735,200
7110109	Tarifa Shkollimi	129,671,048
7110110	Konkurse pranimi	731,000
7111005	Shërbime të ndryshme analiza	1,745,325
7111099	Te tjera te ardh.sekondare dhe sherbimesh	4,490,594
7207010	Sponsorizime	693,773
	<b>Totali</b>	<b>142,206,940</b>

Ne mbeshtetje dhe ne zbatim te: VKM-së nr.699 datë 22.10.2014 “Për përjashtimin ose reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit e studentëve që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, master profesional, master shkencor, VKM-së nr.638, datë 22.7.2015, “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016”, VKM-së nr. 866, datë 23.10.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.7.2015, “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe ne programet e integruara te studimeve te ciklit te dyte, me kohe te plote, si edhe tarifat e shkollimit per vitin akademik 2015 - 2016” ku theksohet se: “Përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentet që ndjekin ciklin e parë të studimeve “Bachelor”, programet jouniversitare profesionale dhe programet e integruara te studimeve te ciklit te dyte “Master i Shkencave”, me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe qe vijne nga keto shtresa sociale, si: personat që nuk shikojnë/ personat që nuk dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre, jetimët, studentë të cilëve njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familjet e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore si “familje në nevojë”, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, fëmijët e ish-të përndjekurve politikë, fëmijë të policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të prekurit nga sëmundja HIV-AIDS dhe paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit studentet që ndjekin ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” ose “Master i Shkencave”, me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si: personat që nuk shikojnë/ personat që nuk dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre, jetimët, studentë të cilëve njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familjet e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore si “familje në nevojë”, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, fëmijët e ish-të përndjekurve politikë, fëmijë të policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të prekurit nga sëmundja HIV-AIDS “, numri i perfituesve per vitin akademik 2015-2016 eshte si men poshte:

## NUMRI I STUDETEVE TE PERJASHTUAR NGA TARIFA SHKOLLIMIT 15-16

<b>Totali</b>	<b>246 studente</b>	<b>5.371.754 leke</b>
---------------	---------------------	-----------------------

Per vitin akademik aktual 2016-2017 jane regjistruar ne vitet e para ne ciklin e pare te studimeve sistemin bachelor me kohe te plote 2257 studente, ne ciklin e dyte te studimeve master profesional me kohe te plote 405 studente, dhe ne ciklin e dyte te studimeve master shkencor me kohe te plote 202 studente.

Dega e finances se USH-se ka realizuar detyrat e meposhtme:

1. Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit, miratuar sipas ligjit nr.147/2015, dt. 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016", udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.2, dt. 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", udhëzimi nr.34, dt.28.12.2015 "Për zbatimin e buxhetit për vitin 2016", me vendimet e organeve kolegjiale perkatesisht vendimin e senatit akademik nr.15, dt.14.01.2016 „Per miratimin e buxhetit te Universitetit per vitin 2016“, dhe vendimin e keshillit te administrimit te Ush-se nr.19, dt.15.01.2016.
2. Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2016
3. Përgatitja e raportit vjetor të monitorimit (aneksi 13-të) të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për vitin 2015, si dhe raporti i 3-mujor Janar – Mars 2016 si dhe raporti 6 - mujor, 9 - mujor për vitin 2016.
4. Përgatitja e raportit vjetor të konsoliduar të Pasqyrave Financiare për vitin 2015
5. Hartimi i projektbuxhetit për vitin 2017, si dhe periudhën afatmesme 2017-2019
6. Ndjekja e procedurave për implementimin e projekteve me financim të huaj. Raportimi në Ministrinë e Financës për çdo muaj.

### **Raportimi i financimeve te huaja**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr.147/2015, dt. 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016", të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të VKM nr. 775 datë 24.9.2010 "Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 8 datë 17.02.2003 "Për evidentimin, rregjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj" kemi derguar ne menyre periodike (cdo muaj) raportimin e financimeve te huaja. Pagesat behen ne monedhen shqiptare npr bankes se nivelit te dyte.

- 1 Emertimi i Projektit: **Erasmus Mundus Action 2, Strand 1, Lot 6 SIGMA Partnership (Critical Skills Learning for Innovation, Sustainable Growth, Mobility and Employ Ability in the Multicultural Environment of the Western Balkans – Grant Agreement No.2012-2669-001-001-EM Action 2+Sigma Agile**

Donatori / Kreditori: Universiteti i Varshaves

Gjendja me 01.01.2016: 102,694.85 LEKE

**Disbursuar** gjate periudhes 1 Janar 2016 - 31.12. 2016 0 LEKE

**Shpenzuar** gjate periudhes 1 Janar 2016 -31.12.2016 3,450 lek kom.bankar



**Gjendja ne fund te periudhes raportuese 31.12.2016: 99,244.85 LEKE**

**2. Emertimi i Projektit: *Developing third mission activites in Albanian Universites (U3M-AL)***

**Donatori / Kreditori: Universiteti i Leonit - Spanje**

**Gjendja me 01.01.2016: 378,343.71 lek**

**Disbursuar gjate periudhes 1 Janar 2016 - 31.12. 2016 0 leke**

**Shpenzuar gjate periudhes 1 Janar 2016 -31.12.2016 378,343.71 leke**

**Gjendja ne fund te periudhes raportuese 31.12.2016: 0 LEKE**

**3. Emertimi i Projektit: *“Modernizing and harmonizing maritime education in Montenegro and Albania” 54425***

**TEMPUS-1-2013-ME-TEMPUS –JPCR(2013-4538/001-001)(MArED)**

**Donatori / Kreditori: Universiteti Malit te Zi, Cetinje 2 , 81000 Podgorice**

**Gjendja me 01.01.2016: 1,982.7 leke**

**Disbursuar gjate periudhes 1 Janar 2016 - 31.12. 2016 2,748,526.67 leke**

**Shpenzuar gjate periudhes 1 Janar 2016 -31.12.2016 2,007,256 leke**

**Gjendja ne fund te periudhes raportuese 31.12.2016: 743,253.37 lek**

**4. Emertimi i Projektit: *Empowering universities to fulfill their responsibility for quality assurance***

**(EUREQA) 530631-TEMPUS-1-2012-BE-TEMPUS -JPGR**

**Gjendja me 01.01.2016: 0 lek**

**Disbursuar gjate periudhes 1 Janar 2016 - 31.12. 2016 551,347.97 leke**

**Shpenzuar gjate periudhes 1 Janar 2016 -31.12.2016 551,347.97 leke**

**Gjendja ne fund te periudhes raportuese 31.12.2016: 0 lek**

**5. Emertimi i Projektit: *“Sports Professions – Education, Emloyment in Balkan Region, Universiteti i Shkodres”,***

**Donatori / Kreditori: The University of Rome "Foro Italico"**

**Gjendja me 01.01.2016 39,445.08**

**Disbursuar gjate periudhes 1 Janar 2016 - 31.12 2016 2,557,389.98 LEKE**

**Shpenzuar gjate periudhes 1 Janar 2016 -31.21.2016 1,927,001 leke**

**Gjendja ne fund te periudhes raportuese 31.12.2016: 669,834.06 lek**

## ***Auditimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit***

*Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit eshte realizuar auditimi sipas programit me shkresen nr.9815/1, dt.10.10.2016 me objekt: Auditim i plote duke bere vleresimin e sistemeve te kontrollit te brendshem, vleresimin e risku, dhenien e rekomandimeve dhe keshillave per permiresimin e sistemeve ne arritjen e objektivave per periudhen 01.01.2014-30.09.2016.*

*Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet e lena nga ana e auditit te brendshem te MAS, po merren ne konsiderate maksimalisht nga ana e universitetit te Shkodres, ne menyre qe te minimizojë riskun dhe te arrije nje standard optimal ne zbatimin e ligjshmerise.*

### ***Problematikat:***

*Se pari mungesa e bordit te administrimit ka ndikuar negativisht ne ndermarrjen e veprimeve per te ndryshuar planin e investimeve, apo regjistrin e parashikimit ne disa zera te nevojshem. Titullaret e kane gjykuar pa mbeshetje ligjore marrjen e vendimeve nga ana e senatit akademik per ndryshime ne buxhetin e vitit 2016.*

*Se dyti ndarja e detyrave nga ana e titullarit per degen e finances dhe degen e sherbimeve dhe blerjeve eshte jo-homogjene. Specialiste te Deges se finances jane ngarkuar me detyra te deges se sherbimeve duke krijuar hendek ne procese te caktuara pune qe mbulon sektori i finances ose mbingarkese te specialisteve te finances.*

*Se treti kemi hasur veshtiresi ne pagesen e pedagogeve me kohe te pjesshme . Nga ana e departamenteve nuk jane marre masat e duhura per te zbatuar me perpikmeri legjislacionin ne fuqi dhe udhezimet e titullarit.*

*Se katerti proceset gjyqesore qe kemi pasur lidhur me disa pedagoge te punesuar prane Ush-se (Fakulteti i drejtesise), dhe pezullimi i tyre per afro 3 muaj, vonesa e shpalljeve te vendeve vakante nga ana e departamenteve perkatese si artet, edukimi fizik dhe sportet, gazetaria, matematika, informatika, gjuhet e huaja, apo skualifikimi i aplikuesve per mos plotesim kushtesh, kane shkaktuar nje mos-realizim te planit te pagave nga granti per vitin 2016. Po ashtu pjese ne kete mos-realizim perben edhe mos dhenia e shperblimit nga fondi i vecante.*

*Se pesti kontrata ne vazhdim me objekt „Ndertim godine e re fakulteti ekonomik“ ka renduar situaten financiare te USh-se duke qene se pjesa e mbetur e punimeve duhet te mbulohet nga te ardhurat e USh-se.*

*Bashkengjitur ketij materiali kopje të evidencave të të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore të miratuara nga Dega e thesarit Shkodër.*

**KANCELARI**

*Av. dr. Artan Kolnikaj*